

URDHËR
Nr. 11, datë 14.1.2022

PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR NJË SHFRYTËZIM TË QËNDRUESHËM TË REZERVAVE TË PELAGJIKËVE TË VEGJËL NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEORAFIKE 17 DHE 18) [REKOMANDIMI I GFCM/44/2021/20]

(Ndryshuar me urdhrin nr. 197, datë 18.3.2024; nr. 406, datë 25.4.2025; nr. 127, datë 9.2.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të Marrëveshjes, “Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003, të neneve 13 dhe 14, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e rekomandimit GFCM/44/2021/20 të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për një shfrytëzim të qëndrueshëm të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, Rekomandim i GFCM/46/2023/5, “Për zgjatjen e regjimit tranzitor të peshkimit dhe vendosja e një limiti zëniesh për vitin 2024, për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, bazuar nga rekomandimi GFCM/44/2021/20, rekomandimi GFCM/47/2024/4, “Mbi një regjim afatgjatë dhe vendosjes së një limiti zëniesh për vitin 2025 për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, bazuar nga rekomandimi GFCM/44/2021/20, dhe rekomandimi GFCM/48/2025/5, “Mbi një regjim afatgjatë dhe vendosjes së një limiti zëniesh për vitin 2026 për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, i cili ndryshon rekomandimin GFCM/44/2021/20 dhe shfuqizon rekomandimet GFCM/42/2018/8, GFCM/40/2016/3, GFCM/39/2015/1, GFCM/38/2014/1, GFCM/37/2013/1 dhe GFCM/30/2006/1, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij”.

2. Anijet e peshkimit që peshkojnë pelagjikë të vegjël (sardele dhe açuge) të zbatojnë ndalimin në peshkim, për një periudhë 30-ditore, si më poshtë:

- për sardelen 15 shkurt–16 mars;
- për açugen 1 qershor–30 qershor.

3. Ndalohet peshkimi i pelagjikëve të vegjël për anijet mbi 12 m gjatësi të përgjithshme, deri në largësinë 6 milje detare nga bregu për periudhën 1 prill–31 dhjetor.

4. Gjatë periudhës së ndalimit, anijet që peshkojnë pelagjikët e vegjël nuk lejohen të ndërrojnë rrjetat e përdorura, me qëllim peshkimin e tyre nga trata pelagjike në koshilok ose anasjelltas.

4/1. Limiti i zënieve të pelagjikëve të vegjël, të ndara sipas specieve për vitin 2026, është si më poshtë:

- a) açuge: 663 tonë;
- b) sardele: 743 tonë.

5. Ky plan menaxhimi është i zbatueshëm deri më 31 dhjetor 2029.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Inspektorati i Peshkimit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

7. Urdhri nr. 435, datë 25.7.2019, “Për masat e mëtejshme urgjente në vitet 2019–2021, për rezervat e pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18) [Rekomandimi GFCM/42/2018/8]”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

REKOMANDIM I GFCM/44/2021/20

PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR NJË SHFRYTËZIM TË QËNDRUESHËM TË REZERVAVE TË PELAGJIKËVE TË VEGJËL NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEOGRAFIKE 17 DHE 18)

Duke marrë parasysh se qëllimi i Marrëveshjes Për themelimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (marrëveshja e GFCM-së) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke kujtuar që në arritjen e qëllimit të Marrëveshjes së GFCM-së, GFCM-së do të miratojë rekomandime për masat e ruajtjes dhe të menaxhimit, që synojnë sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të aktiviteteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të peshkimit dhe, që, në miratimin e rekomandimeve të tilla, GFCM-ja do t'u kushtojë vëmendje të veçantë masave për të parandaluar mbipeshkimin dhe për të minimizuar hedhurinat, si dhe ndikimet e mundshme në peshkimin artizanal dhe komunitetet lokale;

duke marrë parasysh se GFCM-ja do të miratojë masat e menaxhimit të peshkimit, bazuar në një qasje në ekosistem për të garantuar ruajtjen e rezervave në nivele të cilat mund japin prodhimin maksimal të qëndrueshëm (MSY);

duke kujtuar që Deklarata Ministeriale e Maltës më 2017-ën për zgjerimin e bashkëpunimit për peshkimin dhe akuakulturën në Detin Mesdhe ("*MedFish4Ever Declaration*") kërkon që në kontekstin e krijimit të një kuadri të menaxhimit të peshkimit të bazuar në ekosistem, të gjitha format kryesore të peshkimit të menaxhohen me plane menaxhimi;

duke marrë parasysh se GFCM-ja duhet të zbatojë një qasje të kujdesshme në përputhje me Marrëveshjen për Zbatimin e Dispozitave të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit të 10 dhjetorit 1982, në lidhje me Ruajtjen dhe Menaxhimin e Burimeve Peshkore për Speciet Shumë Migruese të 4 gushtit 1995 dhe Kodin e Sjelljes për një Peshkim të Përgjegjshëm të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë së Kombeve të Bashkuara (FAO);

duke marrë parasysh se Kodi i Sjelljes i FAO-s për një Peshkim të Përgjegjshëm parashikon që shtetet "duhet të zbatojnë gjerësisht qasjen e kujdesshme në ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve ujore të gjalla, për t'i mbrojtur ato dhe për të ruajtur mjedisin ujor, duke marrë parasysh dëshmitë më të mira shkencore të disponueshme. Mungesa e informacionit të përshtatshëm shkencor nuk duhet të përdoret si arsye për shtyrjen ose mosplotësimin e masave për ruajtjen e specieve objekt peshkimi, specieve të lidhura ose të varura dhe specieve joobjekt peshkimi dhe mjedisin e tyre";

duke marrë parasysh se të gjitha masat e formuluar nga GFCM-ja do të bazohen në këshillat më të mira shkencore të disponueshme, duke marrë parasysh faktorët përkatës mjedisorë, ekonomikë dhe socialë;

duke kujtuar rekomandimin GFCM/41/2017/7 për një plan rajonal veprimi për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së;

duke marrë parasysh se vdekshmëria nga peshkimi duhet të mbahet nën pragjet e sigurisë për të siguruar një prodhimtari të lartë afatgjatë, duke limituar riskun e kolapsit të burimeve dhe duke garantuar peshkim më të qëndrueshëm;

duke marrë parasysh rëndësinë socioekonomike të peshkimit dhe nevojën për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit;

duke kujtuar se një plan menaxhimi (GFCM/37/2013/1) dhe disa masa emergjente tranzitore janë adaptuar, për të ngadalësuar nivelet e larta të vdekshmërisë nga peshkimi, që nga 2013-ta (GFCM/38/2014/1, GFCM/39/2015/1, GFCM/42/2018/8) dhe që këto zbatuan ndalimin në kohë dhe në hapësirë, duke përfshirë dhe kufizimin në zënie;

duke vënë re se Komiteti i Këshillimit Shkencor të GFCM-së (SAC) ka konsideruar në mënyrë të përsëritur se rezervat e açuges dhe të sardeles në nënzonat gjeografike (GSA) 17 dhe 18 janë në mbishfrytëzim;

duke kujtuar se mbështetur në këshillat më të fundit shkencore të SAC-së më 2021-shin rezervat e açuges dhe të sardeles rezultojnë të mbishfrytëzuara dhe në mbishfrytëzim, për açugen ($F/FMSY = 1.51$, $SSB/SSBlim = 1.05$, $SSB/SSBpa = 0.80$) dhe për sardelen ($F/FMSY = 4.43$, $SSB/SSBlim = 1.11$, $SSB/SSBpa = 0.67$);

duke vënë re se Komiteti i Këshillimit Shkencor të GFCM-së (SAC) në mbledhjen e tij të 22-të vuri në dijeni se gjendja e burimeve të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik, pavarësisht masave të marra, ishin të mbishfrytëzuara dhe në mbishfrytëzim (Raporti i $F_{current}/FMSY$ për açugen 1.51 dhe për sardelen 4.43, respektivisht, biomasa aktuale e rezervave të riprodhueseve ishte midis Bpa dhe Blim për të dyja speciet);

miraton, në përputhje me dispozitat e neneve 5b, 8b dhe 13 të Marrëveshjes me GFCM-në, rekomandimin e mëposhtëm.

PJESA 1

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË PLANIT SHUMËVJEÇAR

1. Rekomandimi i tanishëm vendos një plan menaxhimi shumëvjeçar për një aktivitet peshkimi pelagjik të qëndrueshëm në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18 GFCM) për shfrytëzimin e rezervave kyçe të pelagjikëve të vegjël (açuge dhe sardele), nga anije me rrethim dhe pelagjike. Në bazë të këshillave të SAC-së, fusha e këtij rekomandimi mund të zgjerohet në vegla dhe në specie të tjera.

2. Plan i shumëvjeçar i menaxhimit duhet të jetë në përputhje me qasjen e kujdesshme. Duhet të projektohet për të siguruar prodhim të lartë afatgjatë, në përputhje me Prodhimin Maksimal të Qëndrueshëm (MSY) dhe të garantohet një risk i ulët për kolapsin e rezervave, duke mbajtur aktivitetin e peshkimit dhe industrinë e varur prej tij në nivele të qëndrueshme.

3. Palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC), anijet e të cilave peshkojnë në mënyrë aktive në nënzonat 17 dhe 18 të GFCM-së, dakordësohen për zbatimin e planit shumëvjeçar të menaxhimit për speciet e rrezikuara dhe në përputhje me objektivat dhe masat e përgjithshme dhe specifike të vendosura në këtë rekomandim.

4. Një grup masash tranzitore menaxhuese të kujdesshme për detin Adriatik do të zhvillohen në mënyrë që të sigurohet se duke minimizuar ndikimet socioekonomike dhe duke finalizuar këshillat shkencore nga SAC-ja, rezervat dhe aktiviteti i peshkimit përparojnë drejt niveleve biologjikisht të qëndrueshme.

5. Plan i shumëvjeçar i menaxhimit për këto forma peshkimi do të ndjekë, gjithashtu, reduktimin e aktivitetit të peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (këtu e më poshtë “PPP”) në nënzonat 17 dhe 18 të GFCM-së.

Shtrirja gjeografike

6. Plan i shumëvjeçar i menaxhimit i parashikuar nga ky Rekomandim do të zbatohet në nënzonat 17 dhe 18 të GFCM-së.

Përkufizime

7. Për qëllim të këtij Rekomandimi:

a) “ F_{msy} ” nënkupton vlerën e vdekshmërisë nga peshkimi të vlerësuar, që me një model peshkimi të dhënë dhe nën kushtet aktuale mesatare mjedisore, jep prodhimin maksimal afatgjatë,

në rastin e açuges dhe sardeles “F_{msy}Proxy” e vendosur bazohet në shkallën e shfrytëzimit të Pattersonit me E=0.4;

b) “B_{lim}” nënkupton pikën kufitare të referimit, të shprehur me biomasën e rezervës së riprodhueseve, nën të cilën mund të ketë zvogëlim të kapacitetit riprodhues;

c) “B_{escapment}” limiti i biomasës nën të cilin rezerva konsiderohet të ketë kapacitet riprodhues të reduktuar, duke përfshirë çdo biomasë të nevojshme të identifikuar;

d) “F_{cap}” limit i F-së, i cili përdoret për të dhënë këshilla mbi zëniet, por pa vlerësuar probabilitetin e SSD > B_{escapment};

e) “Rezervat brenda limiteve biologjike të sigurta” nënkupton rezervat me një probabilitet të lartë që biomasë e riprodhueseve në fund të vitit paraardhës të jetë më e lartë se pika e referencës e biomasës (B_{lim});

f) “Deti Adriatik” nënkupton nënzonat gjeografike 17 dhe 18 të GFCM-së, të përcaktuara në rezolutën GFCM/33/2009/2;

g) “Anije që peshkon aktivisht” nënkupton çdo anije pelagjike ose me rrethim që peshkojnë rezervat kyçe dhe të autorizuar nga CPC-ja, me flamurin e tyre, për të kryer aktivitete të veçanta peshkimi, gjatë një periudhe të caktuar, në një zonë të caktuar ose për një formë peshkimi të caktuar në kushte specifike;

h) “Rezerva kyçe” nënkupton organizmat detarë që u përket specieve të caktuara;

i) “Açuge” nënkupton peshqit që i përkasin species *Engraulis encrasicolus*;

j) “Sardele” nënkupton peshqit që i përkasin species *Sardina pilchardus*;

k) “Pelagjike të vegjël” nënkupton rezervat e açuges dhe të sardeles;

l) “Pelagjike” nënkupton anijen e peshkimit që operon e vetme ose çift duke përdorur tratë pelagjike;

m) “Me rrethim” nënkupton anijet e peshkimit që operojnë, duke përdorur koshilok për gjuetinë e pelagjikeve të vegjël;

n) “Peshkim të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP)” ose “Peshkim PPP” nënkupton aktivitetin e përcaktuar në paragrafin 3 të Planit të Veprimit Ndërkombëtar për Parandalimin, Shkurajimin dhe Eliminimin e Peshkimit të Paligjshëm, të Parregulluar dhe të Paraportuar, të 2001-shit, nga FAO, në vijim referuar si “peshkim PPP” dhe duke ndjekur dispozitat e Rekomandimit GFCM/41/2017/7, për një plan veprimi rajonal për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së;

o) “Vend zbarkimi i përcaktuar” nënkupton portet, vende afër me bregun, të përcaktuara nga palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC), në përputhje me Rekomandimin GFCM/40/2016/1 për një skemë rajonale mbi masat e ndërmarra nga shtetet port për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së, duke përfshirë terminale në det të hapur dhe instalime të tjera për zbarkimin, transbordimin, paketimin, përpunimin, furnizimin me karburant të anijeve të peshkimit, ku lejohet zbarkimi, transbordimi, paketimi dhe/ose përpunimi i produkteve të peshkimit.

PJESA 2

OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË PLANIT SHUMËVJEÇAR TË MENAXHIMIT DHE MASAT TRANZITORE NË NËNZONËN GJEOGRAFIKE 17 DHE 18

8. Plani do të synojë të kontribuojë në objektivat e përmendur në nenin 2 dhe në parimet e listuara në nenin 5 të Marrëveshjes së GFCM-së.

9. Plani, në veçanti duhet:

a) të zbatojë një qasje të kujdesshme të menaxhimit të peshkimit;

b) të sigurojë një shkallë shfrytëzimi të rezervave kyç në nivelet e Prodhimit Maksimal të Qëndrueshëm (MSY), sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 31 dhjetor 2028, duke marrë parasysh ndërveprime të mundshme midis dy specieve;

c) të parandalojë rritjen e kapaciteteve të peshkimit në varësi me vitin 2014;
d) të mbrojë zonat e çeljes dhe të riprodhimit dhe habitatet e rëndësishme për rezervat kyçe;
e) të kontribuojë në zhdukjen e hedhurinave, duke shmangur dhe duke reduktuar, zëniet e padëshiruara, dhe duke siguruar që të gjitha zëniet të zbarkohen;

f) Të sigurojë masat për të rregulluar kapacitetet e peshkimit dhe zëniet në nivelet e vdekshmërisë nga peshkimi të përputhshme me MSY-në, me synimin për të pasur një flotë ekonomikisht të qëndrueshme dhe pa mbishfrytëzuar burimet biologjike detare.

10. Plani i menaxhimit do të bazohet në një qasje me dy faza, nga ku: a) në dy vitet e para, me një vit tranzitor të tretë (në rastin kur kushte të caktuara nuk do të arrihen (neni 12), do të zbatohen kufizime në zënie dhe kufizime në hapësirë dhe në kohë; dhe b) nga 2024 ose 2025, në bazën e të dhënave të reja shkencore, SAC-ja do të vlerësojë gjendjen e rezervave dhe bazuar në Rregullat e Kontrollit të Zënieve (*Harvest Control Rule (HCR)*) propozon masa të mëtejshme dhe këshillon kufizime vjetore të zënieve për speciet, në përputhje të dispozitave të pjesëve 2–3–4–5–6 të këtij Rekomandimi, që do të kontribuojnë në arritjen e F_{msy} ose $F_{msyProxy}$ dhe duke qëndruar brenda limiteve të sigurta biologjike.

11. Më 2022-shin dhe 2023-shin duhet të vendoset një regjim tranzitor i peshkimit. CPC-ja duhet të sigurojë vendosjen e kufizimit të zënieve në nivel kombëtar ose si zënie të përbashkëta për pelagjikët e vegjël, në përputhje me reduktimin vjetor prej 5% për açugen dhe 8% për sardelen në 2022-shin, dhe 5% për açugen dhe 9% për sardelen në 2023-shin. Ky reduktim i tillë duhet të jetë në përputhje me kufizimet e 2021-shit. Bazuar në këtë nen, limiti i zënieve për 2022-shin dhe 2023-shin, me një shpërndarje të përkohshme, është përcaktuar në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij Rekomandimi.

12. Më 2022-shin dhe 2023-shin, CPC-ja do të angazhohet plotësisht për të mbështetur dhe për të përfunduar vlerësimin e rezervave të sardeles dhe Strategjisë së Vlerësimit të Menaxhimit, siç është planifikuar në nenin 16 dhe në përputhje me shtojcën 12 të raportit të SAC 2021. Nëse deri në mbledhjen vjetore të GFCM-së më 2023-shin, vlerësimi i rezervave të sardeles dhe Strategjisë së Vlerësimit të Menaxhimit (*management strategy evaluation (MSE)*) nuk do të jenë të plota, atëherë GFCM-ja do të sigurojë që periudha tranzitore të zgjatet me një vit, për të siguruar që vlerësimi i rezervave dhe i MSE-së për sardelen të ketë përfunduar dhe vendos, bazuar në këshillat e SAC-së mbi kufizimet e zënieve, që do të zbatohen më 2024-ën, bazuar në gjendjen më të përditësuar të disponueshme të rezervës.

13. Për CPC-në me zënie të deklaruara më 2014-ën, nën 2 500 tonë, është vendosur një limit i përbashkët i zënieve, ku do të zbatohen të njëjtat reduktime, siç është përcaktuar në nenin 11 dhe për periudhën 2022–2023, limiti i zënieve është përcaktuar në shtojcën 1. CPC-të e përfshira në kushtet e këtij neni, nuk duhet të tejkalojnë 70% të totalit të zënieve të përbashkëta.

14. Kufizimi i zënieve, për periudhën 2022–2023 ose 2024, për CPC-në në nenet 11–13 do të vendoset pa paragjykuar diskutimet që do të zhvillohen në kontekstin e grupit të punës të cituar në nenin 15 të këtij Rekomandimi.

15. Do të vendoset një grup pune nga GFCM-ja më 2022-shin, brenda tridhjetë ditëve kalendarike nga mbledhja e vitit 2022 të SAC-së, në mënyrë që të vendoset një çelës shpërndarjeje i drejtë dhe i barabartë për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik, duke marrë parasysh përpjekjet e ndërmarra nga CPC-ja për të menaxhuar peshkimin e pelagjikëve të vegjël dhe zëniet historike, dhe duke zbatuar në disa raste rregulla më strikte se ato të përcaktuara në këtë Rekomandim, bazuar edhe në konsiderata socio-ekonomike.

16. SAC-ja, në mbledhjen e tij të 23-të, në vitin 2022, do të urdhërojë: 1. WGSASP-në për të përfunduar vlerësimin e rezervave të sardeles në 2022; dhe 2. Grupit të Punës, për Vlerësimin e Masave Menaxhuese (*Workshop on the assessment of management measures (WKMSE)*) për të kryer një Strategji të Vlerësimit të Menaxhimit për të përcaktuar Rregullat e Kontrollit të Zënieve më të përshtatshme për açugen dhe sardelen për t'u zbatuar në përputhje me nenet 17 dhe 18.

PJESA 3 PLANI I MENAXHIMIT AFATGJATË

17. Është përcaktuar një plan menaxhimi afatgjatë për periudhën 2024 ose 2025–2029. Çdo vit, mbi bazën e këshillave të SAC-së dhe afateve të këshillimit përcaktuar në nenin 35, GFCM-ja duhet të përcaktojë limitin vjetor të zënieve për njëërën specie, bazuar në HCR, në përputhje me nenin 18, i cili do të propozohet nga WKMSE-ja dhe do të miratohet nga SAC-ja më 2023-shin ose 2024-ën.

18. HCR-ja për njëërën specie, së bashku me masat menaxhuese të lidhura me kufizimet e zënieve, duhet të sigurojë një probabilitet të ulët, që SSB-ja të zbresë nën Blim (5% probabilitet) dhe do të bazohet në secilën:

- a) në një strategji HCR me F_{msy} fikse, bazuar në F_{msy} ose $F_{msy}Proxy$ dhe B_{pa} ; ose
- b) në një largim të biomasës HCR, bazuar në një shkallë optimale të biomasës të larguar (*Bescapement*) dhe, nëse është i nevojshëm, një limit të vdekshmërisë nga peshkimi (F_{cap});
- c) HCR të tjera të propozuara nga WKMSE-ja, në përputhje me termat e referencës së shtojcës 2 të GFCM-së 42/2018/8.

19. Limitet e zënieve të shpërndara midis CPC-së do të bazohen në rezultatet e grupit të punës cituar në nenin 15.

20. Zëniet të cilat tejkalojnë limitin e zënieve të përcaktuar për speciet në fjalë mund të zbriten nga limiti i zënieve të species objekt peshkimi, me kusht që të mos kalojë 9% të limitit të zënies për atë specie. Kjo dispozitë do të zbatohet vetëm kur gjendja e rezervës së specieve jo objekt peshkimi të ndodhet brenda limiteve të sigurta biologjike.

21. Gjatë tre vjetëve të parë, duke filluar nga 2024, për secilën nga speciet, ndryshimi midis limiteve vjetore të zënieve, në krahasim të vitit të mëparshëm, nuk duhet të jetë më shumë se 10% ndërsa për vitet e mbetura të planit nuk duhet të kalojë 20%. Këto kufizime në ndryshueshmërinë midis limiteve vjetore të zënieve nuk do të zbatohen në rastet kur rezervat nuk janë brenda kufijve biologjikisht të sigurta.

Masat mbrojtëse

22. Gjatë periudhës tranzitore dhe/ose gjatë planit afatgjatë të menaxhimit, kur këshillat shkencorë tregojnë se biomasa e riprodhueseve për secilin nga rezervat kyç ndodhet nën Blim, bazuar në këshillat shkencorë të SAC-së, masa të tjera korrigjuese duhet të ndërmerren nga GFCM-ja për të siguruar kthimin e rezervave mbi nivelet e afta të gjenerojnë MSY. Në veçanti, masa të tilla korrigjuese mund të përfshijnë pezullimin e peshkimit për ato specie dhe reduktimin e përshtatshëm të limiteve të zënieve.

PJESA 4 MASAT TEKNIKE

Kufizimet në hapësirë dhe në kohë

23. Gjatë periudhës tranzitore, CPC-ja duhet të zbatojnë kufizime në kohë në nivele flote (pavarësisht se nuk është njëkohësisht për anijet pelagjike dhe me rrethim) në funksion të mbrojtjes së rezervave gjatë periudhës së riprodhimit. Këto kufizime duhet të mbulojnë të gjithë shpërndarjen e pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik dhe të ndikojnë të gjitha flotat që gjuajnë pelagjikët e vegjël, për një periudhë jo më të vogël se 30 ditë të vazhdueshme për segment flote. Anijet që i përkasin flotës së ndikuar nga këto kufizime nuk lejohen të ndërrojnë veglën e përdorur për gjuetinë e pelagjikëve të vegjël (trata pelagjike në koshilok ose anasjelltas) gjatë periudhës së ndalimit. Këto mbyllje do të bëhen gjatë afatit kohor të mëposhtëm:

- për sardelen, nga 1 tetori deri më 31 mars;
- për açugen, nga 1 prilli deri më 30 shtator.

24. Në përjashtim të nenit 23, kufizime të tilla në kohë mund të zbatohen për periudha jo më pak se 15 ditë të vazhdueshme për flotat kombëtare me më pak se 15 anije peshkimi me rrethim dhe/ose pelagjike, që peshkojnë në mënyrë aktive për rezervat e pelagjikëve të vegjël.

25. Gjatë periudhës tranzitore, CPC-të duhet të zbatojnë kufizime në hapësirë për anijet me një gjatësi mbi 12 metra për jo më pak se 9 muaj. Ky kufizim duhet të mbulojë 30% të ujërave territoriale të identifikuar si të rëndësishme për fazat e para të jetës së peshqve.

26. CPC-të duhet të njoftojnë Sekretariatit e GFCM-së, jo më vonë se 30 prill 2022, dhe më pas çdo vit, për kufizimet në hapësirë, të përcaktuara në nenet 23 dhe 25, në ujërat nën juridiksionin e tyre, që ato zbatojnë në funksion të mbrojtjes së zonave të riprodhimit dhe çeljes së pelagjikëve të vegjël.

27. Më 2023-shin grupet e punës për pelagjikët e vegjël duhet të analizojnë dhe vlerësojnë benefitet e kufizimeve në hapësirë dhe kohë, në mënyrë që të përcaktohen kufizime të mëtejshme të përshtatshme, në funksion të mbrojtjes së zonave të riprodhimit dhe çeljes së pelagjikëve të vegjël.

PJESA 5 MASAT MENAXHUESE TË FLOTËS

28. CPC-të duhet të sigurojnë që kapaciteti total i flotës, për anijet pelagjike dhe me rrethim, që peshkojnë në mënyrë aktive rezervat kyç të pelagjikëve të vegjël shprehur në tonazh bruto (GT) dhe/ose tonazh bruto i regjistruar (GRT), fuqi motorike (kw) dhe numër anijesh, të regjistruar si në regjistrin kombëtar dhe të GFCM-së, të mos tejkalohet, gjatë periudhës të zbatimit të këtij Rekomandimi, kapaciteti i flotës së pelagjikëve të vegjël në 2014.

29. Anijet e peshkimit të autorizuar të gjuajnë rezervat kyç të pelagjikëve të vegjël, si anijet pelagjike dhe me rrethim në detin Adriatik duhet të jenë të listuara nga CPC-ja e flamurit.

30. CPC-të njoftojnë Sekretariatit e GFCM-së jo më vonë se 1 gusht të vitit të parë dhe deri në 31 mars për vitet pasardhëse, listën e anijeve të peshkimit që gjuajnë në mënyrë aktive rezervat e pelagjikëve të vegjël gjatë atij viti ose në vitet pasardhëse. Lista duhet të përmbajë, për secilën anije, informacionin e parashikuar në shtojcën 3 të Rekomandimit GFCM/42/2018/5.

31. Secila CPC duhet të sigurojë ngritjen e mekanizmave të përshtatshëm për regjistrimin e secilës anije në regjistrin kombëtar, për regjistrimin e zënieve dhe sforcos me anë të librave të anijes, si dhe monitorimin e aktivitetit të anijeve të peshkimit dhe të zbarkimeve, duke kryer kampionime të sforcos dhe të zënieve, në përputhje të rregullave të përcaktuara nga secila CPC.

32. Dispozitat e mësipërme nuk paragjykojnë Rekomandimin GFCM/33/2009/7, në lidhje me standardet minimale për ngritjen e një sistemi monitorimi të anijeve në zonën e zbatimit të GFCM-së.

33. Në përjashtim të nenit 28, flotat kombëtare me më pak se 10 anije me rrethim dhe/ose pelagjike që gjuajnë në mënyrë aktive rezervat e pelagjikëve të vegjël, të regjistruara si në regjistrin kombëtar, si të GFCM-ja më 2014-ën, duhet të sigurojnë që kapaciteti total i flotës, shprehur në tonazh bruto (GT) dhe/ose tonazh bruto i regjistruar (GRT), fuqi motorike (kw) dhe numër anijesh, të mos rritet me më shumë se 50%, gjatë periudhës së zbatimit të këtij Rekomandimi.

PJESA 6 MONITORIMI SHKENCOR, PËRSHTATJA DHE NDRYSHIMI I PLANIT

34. SAC-ja duhet të sigurojë, në bazë vjetore duke filluar nga 2022-shi, këshilla mbi statusin e rezervave kyç në detin Adriatik përfshirë këtu objektiva specifike, për të mbajtur vdekshmërinë e peshkimit brenda kufijve të vdekshmërisë nga peshkimi, të dakordësuar dhe të mbajnë ose

rivendosin rezervat kyç në nivelet e afta për të gjeneruar prodhimin maksimal të qëndrueshëm, në përputhje me objektivat e përcaktuar në nenin 9.

35. Meqenëse një ofrim i shpejtë i këshillave shkencore është thelbësorë për një menaxhim korrekt të specieve jetëshkurtër, siç janë rezervat e pelagjikëve të vegjël, në bazë vjetore, CPC-të duhet të sigurojnë të dhëna nga peshkimi për qëllime shkencore (*echo-survey*) dhe peshkimi tregtar (zëniet dhe hedhurinat), të grumbulluara në vitin N, të dërgohen te Sekretariati i GFCM-së nga 1 prilli (viti N+1), për të kryer një përditësim vjetor të vlerësimit të rezervave në maj (viti N+1). Duke filluar nga viti 2024 ose 2025, në bazë vjetore, mbështetur në këshillat shkencore dhe në HRC, duke marrë parasysh efektet socioekonomike në flotë dhe industri, SAC-ja duhet të propozojë kufizime në zënie për njëërën specie, për t'u miratuar nga komisioni i GFCM-së në mbledhjen vjetore (viti N+1) dhe të implementohet nga 1 janari (viti N+2).

36. Mbështetur në këshillat e SAC-së, GFCM-ja mund të rishikojë përmbajtjen e planit shumëvjeçar të menaxhimit.

37. Kur këshillat e SAC-së tregojnë se objektivat e përgjithshëm ose specifike të planit shumëvjeçar të menaxhimit nuk janë arritur, GFCM-ja duhet të vendosë masa menaxhuese shtesë dhe/ose alternative, që të kontribuojnë në arritjen e qëllimit.

38. Kur, për çdo rast (p.sh. mungesë të dhënash), SAC-ja nuk do të jetë në gjendje të japë një këshillë të detajuar mbi gjendjen e rezervave kyçe dhe mbi shkallën e tyre të shfrytëzimit, GFCM-ja duhet të vendosë mbi masat menaxhuese më të përshtatshme për të siguruar qëndrueshmërinë e peshkimit. Këto masa duhet të mbështeten në këshillat e SAC-së, në përputhje me qasjen e kujdesshme dhe duke marrë parasysh elementet mjedisore dhe socioekonomike, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e peshkimit.

PJESA 7

MASAT SPECIFIKE PËR TË ADRESUAR AKTIVITETET E PESHKIMIT PPP

39. CPC-të duhet të përcaktojnë një mekanizëm për të siguruar që anijet e peshkimit që peshkojnë në mënyrë aktive në detin Adriatik të deklarojnë zëniet e rezervave kyç. Detyrimi për deklarimin elektronik të zënieve, si dhe i specieve jo objekt peshkimi, në sasi më të mëdha se 50 kg, do të zbatohet pavarësisht nga vëllimi i zënieve të anijeve më të mëdha se 12 m dhe të atyre, zëniet e të cilave kalojnë 10 000 kg në vit, pavarësisht gjatësisë nga 1 janari 2022, ndërsa për anijet me gjatësi nën 12 m, që zënë më pak se 10 000 kg në vit, CoC do të vlerësojë sistemin më të mirë për të raportuar zëniet.

40. Secila CPC duhet të përcaktojë vendzbarkime, ku anijet që peshkojnë në mënyrë aktive rezervat kyç në detin Adriatik të zbarkojnë zëniet e tyre.

41. Për secilin port të përcaktuar, CPC-ja duhet të specifikojnë kohën e zbarkimit dhe të transbordimit.

42. CPC-ja duhet të kryejnë inspektime mbi bazën e analizës së riskut.

43. Është e ndaluar të zbarkohet ose të transbordohet nga anijet e peshkimit çdo sasi të rezervave kyç të zëna nga anije pelagjike dhe me rrethim në detin Adriatik, në çdo kohë dhe port të përcaktuar nga CPC-ja, në përputhje me nenin 40.

44. CPC-ja duhet t'i transmetojnë Sekretariatit të GFCM, jo më vonë se 30 prill 2022, gjithashtu dhe brenda 30 nëntorit të secilit vit, çdo ndryshim në listën e vendzbarkimeve të përcaktuara për zbarkimin e rezervave kyç në detin Adriatik.

45. CPC-ja duhet të angazhohen në bashkëpunimin për të luftuar aktivitetet e peshkimit PPP, në veçanti përmes shkëmbimit të informacionit dhe mbledhjes së informacionit për të luftuar aktivitete të paligjshme.

46. Pjesa 7 e këtij Rekomandimi nuk përjashton zbatimin e Rekomandimit GFCM/41/2017/7 për një plan veprimi rajonal, për të luftuar peshkimin e paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar në zonën e zbatimit të GFCM-së.

PJESA 8

PROGRAMI I MONITORIMIT PËR KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN

47. Anijet që përdorin trata pelagjike ose koshilok, për zënien e rezervave të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik, duhet të lejohen vetëm të kryejnë aktivitete të caktuara peshkimi, nëse këto tregohen në një autorizim të vlefshëm peshkimi të lëshuar nga autoritetet kompetente.

48. Duke filluar nga 30 prilli 2022, anijet e autorizuar me gjatësi mbi 12 m duhet të pajisen me Sistemin e Monitorimit të Aniëve (*vessel monitoring system (VMS)*). CPC-të mund të përjashtojnë anijet me një gjatësi më të vogël se 15 m nga detyrimi për t'u pajisur me VMS, nëse ato operojnë ekskluzivisht në ujërat territoriale të CPC-së dhe/ose nuk qëndrojnë më shumë se 24 orë në det nga koha e nisjes dhe e kthimit në port. CPC-ja duhet të njoftojnë Sekretariatit e GFCM-së për këto përjashtime, si dhe për masat e tjera të kontrollit të vendosura për të monitoruar anijet e peshkimit në fjalë pa vonesa.

49. CPC-ja duhet të monitorojnë konsumin e limitit të zënieve ose kuotën totale të lejuar, të përcaktuar, në përputhje me nenet 11–13 dhe të shtojcës 1 deri në fund të periudhës tranzitore dhe, më pas, në zbatim të nenit 17, si më poshtë:

I. Për CPC të vetme limiti i zënieve, nga periudha kur 80% e kuotës është konsumuar, CPC në fjalë duhet të njoftojë GFCM-në për zëniet në bazë mujore. Ky raportim duhet të dërgohet brenda datës 15 të muajit për muajin paraardhës. Kur limiti i zënieve është arritur, CPC-të duhet të ndalojnë zëniet e pelagjikëve të vegjël ose të njëjës specie, në zbatim të nenit 20.

II. Në rastin e limitit të përbashkët të zënieve, CPC-të duhet të njoftojnë në bazë mujore zëniet. Ky raportim duhet të dërgohet brenda datës 15 të muajit, për muajin paraardhës. Sekretariati i GFCM-së, kur 70% e limitit të përbashkët të zënieve është konsumuar ose një nga CPC-të ka arritur 70% të totalit të limitit të zënieve të përbashkëta, duhet të njoftojë CPC-në në fjalë, të cilat duhet të vendosin një regjim për aktivitetin e peshkimit, në mënyrë që të mos tejkalohet limiti i përbashkët i peshkimit i përcaktuar. Kur limiti i përbashkët i peshkimit është arritur, CPC-të duhet të ndalojnë zënien e pelagjikëve të vegjël ose së njëjës specie.

PJESA 9

SKEMA E PËRHERSHME E INSPEKTIMIT

50. Skema pilot e inspektimit për pelagjikët e vegjël në Adriatik, bazuar në Rekomandimin e GFCM/42/2018/8, duhet të zgjatet deri në 31 dhjetor 2023.

51. Nga 1 janari 2024, GFCM-ja duhet të vendosë një program të përhershëm vëzhgimi dhe inspektimi për të siguruar përputhshmëri me masat menaxhuese dhe konservuese të përmbajtura në këtë Rekomandim.

52. Programi i përhershëm i vëzhgimit dhe i inspektimit (neni 51) duhet të bazohet në rezultatet e projektit pilot (neni 50). Ai do të përmbajë, ndër të tjera, elementet e mëposhtme:

- a) inspektim në det të hapur;
- b) procedurat për hetimin efektiv të një shkeljeje të mundshme të masave të ruajtjes dhe të menaxhimit, të përfshira në këtë Rekomandim, dhe për raportimin në GFCM mbi masat e marra, përfshirë edhe procedurat për shkëmbimin e informacioneve;
- c) dispozitat për veprimet që duhet të ndërmerren kur inspektimet evidentojnë shkelje të rënda, si dhe ndjekja e duhur dhe transparente e këtyre veprimeve, në mënyrë që të mbështetet përgjegjësia e shtetit flamur brenda, sipas programit;
- d) inspektime në port;
- e) monitorimi i zënieve dhe i zbarkimeve, duke përfshirë ndjekjen statistikore për qëllime menaxhimi;

f) program monitorimi specifik, duke përfshirë imbarkimin dhe inspektimin.

PJESA 10 PLANET KOMBËTARE TË MENAXHIMIT

53. Me qëllim të sigurimit të konservimit të përshtatshëm të rezervave të pelagjikeve të vegjël, palët kontraktuese dhe palët jokontraktuese bashkëpunuese (CPC) duhet të zbatojnë masa menaxhuese ose plane kombëtare menaxhuese në detin Adriatik.

54. CPC-ja duhet të njoftojnë Sekretariatit e GFCM, nga 30 shtatori 2022, mbi masa menaxhuese ose plane menaxhuese të zbatuara në nivel kombëtar. Aty ku është e përshtatshme, nëse këto masa modifikohen, CPC-ja do t'i komunikojnë këto modifikime deri më 30 prill të vitit pasardhës.

PJESA 11 DISPOZITAT E FUNDIT

55. Ky plan qëndron në fuqi për shtatë vjet nga data e miratimit të tij.

56. Masat e përmendura në këtë Rekomandim nuk do të paragjykojnë masat më strikte të miratuara nga CPC-të.

57. Mbi bazën e këshillave shkencore, SAC-ja mund të ndryshojë këtë Rekomandim.

SHTOJCA 1

Mundësia për të peshkuar në detin Adriatik (nënzona 17–18) pelagjikët e vegjël gjatë periudhës tranzitore 2022–2023, duke përfshirë një vit të mundshëm (2024), në rast se nuk plotësohen kushtet e përmendura në nenin 12. Në përputhje me nenet 11–13, duke filluar nga limiti i zënieve të vitit 2021, limiti i zënieve të specieve të kombinuara është raportuar në tabelën si më poshtë.

Speciet	EU 2022	EU 2023	[EU 2024]	Limiti i përbashkët i zënieve 2022	Limiti i përbashkët i zënieve 2023	[Limiti i përbashkët i zënieve 2024]
Açuge dhe sardele të kombinuara	91998	84976	[]	4650	4301	[]

(Shtuar me Urdhrin nr. 197, datë 18.3.2024)

REKOMANDIMI GFCM/46/2023/5 **PËR ZGJATJEN E REGJIMIT TRANZITOR TË PESHKIMIT DHE VENDOSJA E NJË LIMITI ZËNIESH PËR VITIN 2024 PËR PELAGJIKËT E VEGJËL NË DETIN ADRIATIK (NËNZONA GJEOGRAFIKE 17 DHE 18), BURUAR NGA REKOMANDIMI GFCM/44/2021/20**

Komisioni i Përgjithshëm për Peshkimin në Mesdhe (KKPM/GFCM),

Duke marrë parasysh se qëllimi i Marrëveshjes për themelimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja e GFCM-së) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, në zonën e zbatimit të GFCM-së;

Duke kujtuar që në arritjen e qëllimit të Marrëveshjes së GFCM-së, GFCM-së do të miratojë rekomandime për masat e ruajtjes dhe të menaxhimit, që synojnë sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të aktiviteteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të peshkimit dhe që në miratimin e rekomandimeve të tilla, GFCM-ja do t'iu kushtojë vëmendje të veçantë masave për të parandaluar mbipeshkimin dhe për të minimizuar hedhurinat, si dhe ndikimet e mundshme në peshkimin artizanal dhe komunitetet lokale;

Duke marrë parasysh këshillat e fundit shkencore, të miratuara nga Komiteti i Këshillimit Shkencor për Peshkimin (KKSHP/SAC) në sesionin e tij të 23-të, që tregojnë një mbishfrytëzim të vazhdueshëm për të dyja resurset kyçe të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik;

Duke marrë parasysh Këshillin e SAC-it, për të vendosur dimensionet minimale (*Minimum Conservation Reference Size, MCRS*), në përputhje me gjatësinë në të cilën 50% e popullatës është e pjekur seksualisht, për sardelen dhe açugen në detin Adriatik, sipas rekomandimit GFCM/44/2021/20, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për një shfrytëzim të qëndrueshëm të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”;

Duke kujtuar paragrafin 12 të rekomandimit GFCM/44/2021/20, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për një shfrytëzim të qëndrueshëm të pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, i cili përcakton se GFCM duhet të sigurojë zgjatjen me një vit të periudhës tranzitore në rast se vlerësimi i Strategjive Menaxhuese (*Management Strategy Evaluation MSE*) dhe vlerësimi i sardeles nuk janë përfunduar më 2023-shin;

Duke kujtuar nevojën për të shtuar një limit zëniesh tranzitore për vitin 2024, i cili nuk është miratuar në rekomandimin GFCM/44/2021/20;

Miraton, në përputhje me dispozitat e neneve 5b, 8b dhe 13 të marrëveshjes me GFCM-në, rekomandimin e mëposhtëm:

1. Mbështetur në parashikimet e paragrafit 12-të të rekomandimit GFCM/44/2021/20, regjimi tranzitor i peshkimit do të zgjatet me një vit dhe do të përfundojë më 31 dhjetor 2024.

2. Mbështetur në parashikimet e paragrafit 12-të të rekomandimit GFCM/44/2021/20 dhe bazuar në këshillat e SAC-it, duhet të miratohet një limit zëniesh për vitin 2024.

3. Mbështetur në situatën e vazhdueshme të mbishfrytëzimit i të dy stockeve pelagjike, bazuar në këshillat shkencorë më të fundit të SAC-it dhe objektivin për të arritur MSY për të dyja stocket, GFCM duhet të vazhdojë reduktimin e aplikuar në vitin 2023 dhe prezantojë për vitin 2024 reduktimin e limitit të zëniesh me 5% për açugen dhe 9% për sardelen, në përputhje me limitin e zëniesh të miratuar më 2023-in. Në këtë linjë, limiti i zëniesh i kombinuar për açugen dhe sardelen janë përcaktuar për vitin 2024 në shtojcën 1.

4. Dimensionet minimale të lejuara për t'u peshkuar për të dy stocket e pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik duhet të jenë:

- 9 cm gjatësia e përgjithshme (TL) për Açugen (*Engraulis encrasicolus*);
- 11 cm gjatësia e përgjithshme (TL) për sardelen (*Sardina pilchardus*).

5. Ndalohet zënia, mbajtja në bordin e anijes, transbordimi, transferimi, zbarkimi, magazinimi, tregtimi, hedhja në treg ose për konsum nga peshkatarët profesionit, të individëve të stockeve kryesore të pelagjikëve të vegjël, nën dimensionet e përcaktuara në paragrafin 4.

6. Pa paragjykuar parashikimet e paragrafit 5 dhe kur një sistem për të shmangur hedhurinat dhe detyrimi për të zbarkuar të gjitha zëniet është miratuar nga një palë kontraktuese (CPC), kapiteni i anijes së peshkimit nuk duhet të hedhë në det këto zënie, dhe duhet të zbarkojë peshkun e zënë, pavarësisht dimensioneve të peshkut, në përputhje me masat e miratuara nga kjo CPC. Të gjitha sasitë e zbarkuara do të regjistrohen dhe nuk duhet të hidhen në treg dhe përdorur për konsum njerëzor.

7. Në përjashtim të paragrafëve 4, 5 dhe 6 dimensionet minimale nuk do të aplikohen për peshkimin tradicional të të vegjëlvë të sardeles me përdorimin e tratave të krahut në Gjirin e Kotorit (*Boka Kotorska Bay*).

SHTOJCA 1

Mundësia për të peshkuar në detin Adriatik (nënzonat 17–18) pelagjikët e vegjël gjatë periudhës tranzitore 2024, sipas CPC-së.

Speciet	EU 2022	EU 2023	EU 2024	Limiti i përbashkët i zënieve 2022	Limiti i përbashkët i zënieve 2023	Limiti i përbashkët i zënieve 2024
Açuge dhe sardele të kombinuara	91998	84976	78111	4650	4301	3979

(Shtuar me urdhrin nr. 127, datë 9.2.2026)

Rekomandimi GFCM/48/2025/5 “Mbi një regjim afatgjatë dhe vendosjes së një limiti zëniesh për vitin 2026 për pelagjikët e vegjël në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, i cili ndryshon rekomandimin GFCM/44/2021/20 dhe shfuqizon rekomandimet GFCM/42/2018/8, GFCM/40/2016/3, GFCM/39/2015/1, GFCM/38/2014/1, GFCM/37/2013/1 dhe GFCM/30/2006/1

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM),

DUKE MARRË PARASYSH që objektivi i Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (Marrëveshja GFCM) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në nivel biologjik, shoqëror, ekonomik dhe mjedisor, të burimeve të gjalla detare në zonën e zbatimit të GFCM;

DUKE KUJTUAR që, në zbatim të objektivit të Marrëveshjes GFCM, GFCM duhet të miratojë rekomandime për masa të ruajtjes dhe menaxhimit që synojnë sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të aktiviteve të peshkimit, me qëllim ruajtjen e burimeve të gjalla detare dhe qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të sektorit të peshkimit dhe që, gjatë miratimit të këtyre rekomandimeve, GFCM duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë masave për të parandaluar mbipeshkimin dhe për të minimizuar hedhjet, si dhe ndikimeve të mundshme në peshkimin në shkallë të vogël dhe komunitetet vendore;

DUKE MARRË PARASYSH që GFCM duhet të miratojë masa menaxhimi të bazuara në qasjen e ekosistemit për peshkimin, për të garantuar ruajtjen e stokut mbi nivelet që mund të prodhojnë kapjen maksimale të qëndrueshme (MSY);

DUKE KUJTUAR Rekomandimi GFCM/44/2021/20 për një plan shumëvjeçar menaxhimi për shfrytëzimin e qëndrueshëm të stoqeve të pelagjikeve të vegjël në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18);

DUKE MARRË PARASYSH që Komiteti Këshillimor Shkencor për Peshkimin (SAC), në sesionin e tij të njëzetegjastë (selia e FAO-s, 2025), konkludoi se stoku i hamsisë evropiane në Detin Adriatik në vitin 2024 kishte një biomasa të stokut të riprodhueshëm mbi pikën e referencës (Bpa) dhe ishte në mbishfrytëzim, për shkak të një rënijeje të lehtë të biomasës dhe një rritjeje të vdekshmërisë së peshkimit, për të cilën u rekomandua një ulje nga Grupi i Punës për Vlerësimin e Stokut të Specieve Demersale;

DUKE MARRË PARASYSH që SAC në sesionin e tij të njëzetegjastë (selia e FAO-s, 2025) konkludoi se stoku i sardeles në Detin Adriatik në vitin 2024 ishte ende i mbishfrytëzuar dhe në mbishfrytëzim dhe se biomasa e stokut të riprodhueshëm kishte rënë më tej dhe tani ishte nën Bpa dhe shumë pranë Blim, duke treguar një përkeqësim të mëtejshëm të stokut;

DUKE MARRË PARASYSH që për ançovisë evropiane, biomasa e stokut riprodhues (SSB) në vitin 2024 vlerësohet në 25 397 ton dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i rregullave të miratuara për kontrollin e kapjeve (HCR) për ançovisë evropiane rezulton në këshillimin për kapje prej 18 198 ton për vitin 2026, ndërsa për sardelen, B/BMSY në vitin 2024 vlerësohet në 0.308 dhe zbatimi i drejtpërdrejtë i HCR të miratuar rezulton në këshillimin për kapje prej 20 000 ton për vitin 2026;

DUKE RIKUJTUAR që GFCM, në sesionin e saj të dyzeteshtatë (selia e FAO-s, 2024), miratoi një HCR specifike për stokun, në përputhje me paragrafin 2 të Rekomandimit GFCM/47/2024/4 për një regjim afatgjatë të peshkimit dhe përcaktimin e kufizimeve të kapjes në vitin 2025 për stoqet e vogla pelagjike në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18), që rrjedh nga Rekomandimi GFCM/44/2021/20.

DUKE VËNË RE NË PAH që HCR-të e miratuara janë rezultat i vlerësimit të strategjisë së menaxhimit (MSE) të kryer nga ekspertë të Grupit të Punës për Vlerësimin e Strategjisë së Menaxhimit, për të marrë në konsideratë një gamë të pasigurive dhe të dhënash të theksuara nga palë të ndryshme të interesuara, duke përfshirë testet e qëndrueshmërisë/stresit që marrin parasysh mungesat potenciale në riprodhim të shkaktuara nga faktorët mjedisorë ose ndryshimet klimatike, si dhe ndryshimet e mundshme në vdekshmërinë natyrore të shkaktuara nga rritja e grabitqarëve, p.sh. nga tonit me pendë blu (*Thunnus thynnus*);

DUKE R që MSE-ja llogarit në mënyrë të qartë dispozitat e paragrafëve 20 dhe 21 të Rekomandimit GFCM/44/2021/20, me qëllim të ofrimit të HCR-ve që përmbushin dispozitat e paragrafit 18, p.sh. që HCR të sigurojë një probabilitet të ulët që biomasa e riprodhueshme e rezervës të bjerë nën Blim (probabilitet 5 për qind);

DUKE MARRË PARASYSH që ndryshimi i paragrafit 21 të Rekomandimit GFCM/44/2021/20 do të kërkonte testimin e plotë të MSE-së për strategjinë e menaxhimit për të verifikuar që HCR-të e miratuara ende do të siguronin një probabilitet të ulët të rënies nën Blim;

DUKE MARRË PARASYSH që, meqenëse futja e transferimit të kuotës ndërvite nuk është testuar në MSE, ky mekanizëm nuk mund të futet pa provuar që do të sigurojë një probabilitet të ulët të rënies nën Blim, sipas kërkesës së paragrafit 18 të Rekomandimit GFCM/44/2021/20;

DUKE MARRË PARASYSH që SAC, në sesionin e tij të njëzet e pestë në vitin 2024 dhe në sesionin e tij të njëzet e gjashtë në vitin 2025, reflektuan mbi masat e menaxhimit që do të zbatohen në fazën afatgjatë të planit shumëvjeçar të menaxhimit, duke vënë në dukje se masat spatio-temporale ishin treguar efektive dhe duke rekomanduar që të mbahen gjatë periudhës së ardhshme;

MIRATON, në përputhje me dispozitat e neneve 5 b), 8 b) dhe 13 të Marrëveshjes GFCM, rekomandon sa vijon:

1. Në përputhje me paragrafët 17 dhe 21 të Rekomandimit GFCM/44/2021/20, bazuar në zbatimin e HCR-ve të listuara në paragrafin 2 të Rekomandimit GFCM/47/2024/4 dhe të këshillës së SAC mbi biomasa-n e sardinës dhe ançovisë europiane në vitin 2024, kufijtë e kapjes për sardinën dhe ançovin për vitin 2026 janë përcaktuar në Aneksin 1, sipas palës kontraktuese dhe palës bashkëpunuese jokontraktuese (CPC).
2. Mbylljet hapësinore dhe kohore të listuara në paragrafët 23 deri në 26 të Rekomandimit GFCM/44/2021/20 do të zgjasin në kuadër të planit afatgjatë të menaxhimit deri më 31 dhjetor 2027 dhe SAC do të rivlerësojë, në sesionin e tij të njëzet e tetë në vitin 2027, përshtatshmërinë dhe vazhdimin e mëtejshëm të këtyre masave nga data 1 janar 2028 deri më 31 dhjetor 2029.
3. Në përputhje me paragrafin 5 të Rekomandimit GFCM/47/2024/4, do të vendoset një sistem i menaxhimit të kuotave për ançovin europian dhe sardinën në Detin Adriatik si më poshtë:
 - Nëse kapja totale tejkalon kufijtë e kapjes në një vit të caktuar, duke marrë parasysh dispozitat e paragrafit 9 të Rekomandimit GFCM/44/2021/20, shumat e tepërta do të kthehen nga ai CPC. Sasitë e tepërta do të zbriten vitin pasardhës nga kufijtë e rregulluar të kapjes së CPC-ve përkatëse.
 - Nëse ndonjë CPC tejkalon kufirin e kapjes gjatë dy viteve të njëpasnjëshme, GFCM do të rekomandojë masa të përshtatshme, të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, një ulje të kufijve të kapjes që i korrespondon të paktën 125 për qind të sasisë së tepërt të kapur.
4. Paragrafët e mëposhtëm që rrjedhin nga Rekomandimi GFCM/37/2013/1 për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin që shfrytëzon stoqet pelagjike të vogla në nënzonën gjeografike

17 (Deti Adriatik verior) dhe për masa kalimtare të ruajtjes për peshkimin e stoqeve pelagjike të vogla në nënzonën gjeografike 18 (Deti Adriatik jugor), si dhe nga paragrafi 7 i GFCM/46/2023/5, do të shtohen në Pjesën IV të Rekomandimit GFCM/44/2021/20:

- a) "Peshkimi i të vegjëlve të stoqeve pelagjike të vogla do të ndalohet me të gjitha llojet e veglave të peshkimit në GSA 17 dhe GSA 18.
- b) Apseti dhe sardelja evropiane më të vegjël se madhësia minimale e ruajtjes në gjatësi totale, siç raportohet më poshtë, nuk duhet të kapen, të mbahen në bord, të transbordohen, të transferohen, të magazinohen, të shiten, të ekspozohen ose të ofrohen për shitje:
 - Apset evropian: 9 cm
 - Sardele: 11 cm

Madhësia minimale e ruajtjes në gjatësi totale mund të shndërrohet në 110 ekzemplarë për kg të apsetit evropian dhe 55 ekzemplarë për kg të sardeles. Ekzemplarët më të vegjël se madhësia minimale e ruajtjes quhen më tej "ekzemplarë nën përmasë".

- c) Pavarësisht nga paragrafi [X] b) më sipër, kur, për shkak të rrethanave të pashmangshme, kapen në mënyrë efektive ekzemplarë nën përmasë të apsetit evropian dhe/ose sardeles, kapiteni i mjetit të peshkimit duhet të regjistrojë këto kapje të ekzemplarëve nën përmasë (peshën dhe numrin e vlerësuar) në një seksion të veçantë të ditarit të peshkimit. Pa paragjykuar dispozitat e paragrafit [X] b) dhe nëse nga një CPC vendoset një sistem për të shmangur hedhjet dhe një detyrim për të zbarkuar të gjitha kapjet, kapiteni i mjetit të peshkimit nuk lejohet t'i hedhë këto kapje dhe, për këtë arsye, duhet të zbarkojë peshkun e kapur, pavarësisht nga madhësia e peshkut të kapur, në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga CPC. Të gjitha sasi të zbarkuara duhet të regjistrohen dhe nuk duhet të ekspozohen, të ofrohen për shitje ose të përdoren për konsum njerëzor. Palët kontraktuese dhe palët bashkëpunuese jokontraktuese që zbatojnë një skemë detyrimi zbarkimi duhet të njoftojnë përmbajtjen dhe karakteristikat e saj në Sekretariatit të GFCM-së përpara seancës pasuese të GFCM-së, me qëllim informimin e palëve të tjera.
- d) Si përjashtim nga paragrafët [X] a) dhe b) më sipër, asnjë MCRS nuk do të zbatohet për peshkimin tradicional të sardeles së re që operon me rrjeta bregdetare në Gjirin e Boka Kotorska.

5. Paragrafët e mëposhtëm që rrjedhin nga Rekomandimi GFCM/37/2013/1 do të shtohen në Pjesën V të Rekomandimit GFCM/44/2021/20:

- a) "Për çdo mjet lundrimi të përfshirë në listën sipas paragrafit 29 të GFCM/44/2021/20, lista do të përmbajë informacionin e përmendur në Aneksin 2."
- b) Çdo mjet lundrimi që nuk është i përfshirë në listën e hartuar sipas paragrafit [X] a) më sipër, nuk lejohet të peshkojë, të mbajë në bord ose të shkarkojë asnjë sasi më të madhe se 20 për qind të anchovisë evropiane dhe/ose sardeles nëse mjeti lundrimi është i angazhuar në një udhëtim peshkimi në nënzonën gjeografike (GSA) 17 dhe/ose GSA 18.
- c) Palët kontraktuese dhe palët bashkëpunuese jokontraktuese do t'i njoftojnë menjëherë Sekretariatit të GFCM çdo shtesë, heqje dhe/ose ndryshim të flotave të peshkimit, të identifikuara sipas paragrafit [X] a) më sipër, të autorizuar për të operuar për burimet pelagjike të vogla në GSA 17 dhe/ose GSA 18, sa herë që ndodhin ndryshime të tilla.
- d) Sekretariati i GFCM do të mbajë të përditësuar listën e mjeteve lundruese të autorizuar për të peshkuar burimet pelagjike të vogla në GSA 17 dhe/ose GSA 18 dhe do ta bëjë atë të

disponueshme në faqen e internetit të GFCM, në përputhje me kërkesat për konfidencialitet të CPC-ve.”

6. Aneksi i Rekomandimit GFCM/44/2021/20 do të modifikohet dhe zëvendësohet si më poshtë:

Aneksi 1

Tabela e mundësive të peshkimit për vitin 2026 sipas palës kontraktuese dhe palëve bashkëpunuese jokontraktuese për sardinën dhe ançovisë në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17–18)

Speciet	Bashkimi Evropian 2026 (tonë)	Shqipëria 2026 (tonë)	Mali i Zi 2026 (tonë)
Ançovi	23 808	663	158
Sardine	40 877	743	243

7. Një Aneks i ri 2 do t'i shtohet Rekomandimit GFCM/44/2021/20 si më poshtë:

Lista e përmendur në pikën 4 a) do të përmbajë, për secilin anije, informacionin e mëposhtëm:

- Emri i anijes
- Numri i regjistrimit kombëtar (kodi i caktuar nga CPC-të)
- Numri i regjistrimit në GFCM (kodi ISO 3-shkronjor i shtetit + 9 shifra, p.sh. xxx000000001)
- Porti i regjistrimit (emri i plotë i portit)
- Emri i mëparshëm (nëse ka)
- Flamuri i mëparshëm (nëse ka)
- Detajet e mëparshme të fshirjes nga regjistra të tjerë (nëse ka)
- Thirrje ndërkombëtare radiofonike (nëse ka)
- VMS (tregoni P/JO)
- Lloji i anijes, gjatësia totale (LOA) dhe tonazhi bruto (GT) dhe fuqia e motorit e shprehur në kW
- Emri dhe adresa e pronarit(ëve) dhe/ose të çarterit dhe/ose operatorit(ëve)
- Llojet kryesore objektivi
- Mjeti kryesor i peshkimit i përdorur për llojet e vogla pelagjike dhe ndarja e segmentit të flotës
- Periudha e lejuar për peshkimin me tral pelagjik ose xibot për llojet e vogla pelagjike (nëse ka një autorizim të tillë)

8. Rekomandimet e mëposhtme shfuqizohen:

- Rekomandimi GFCM/30/2006/1 për menaxhimin e disa peshkimeve që shfrytëzojnë lloje demersale dhe të vogla pelagjike;
- Rekomandimi GFCM/38/2014/1 për masa parandaluese dhe emergjente për vitin 2015 për rezervat e vogla pelagjike në nënzonën gjeografike 17 dhe ndryshimin e Rekomandimit GFCM/37/2013/1;
- Rekomandimi GFCM/37/2013/1 për një plan shumëvjeçar menaxhimi për peshkimet që shfrytëzojnë rezervat e vogla pelagjike në nënzonën gjeografike 17 (Adriatiku verior) dhe për masa kalimtare ruajtjeje për peshkimet që shfrytëzojnë rezervat e vogla pelagjike në nënzonën gjeografike 18 (Adriatiku jugor);
- Rekomandimi GFCM/39/2015/1 për vendosjen e masave të mëtejshme parandaluese dhe emergjente në vitin 2016 për rezervat e vogla pelagjike në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18);
- Rekomandimi GFCM/40/2016/3 për vendosjen e masave të mëtejshme emergjente në vitet 2017 dhe 2018 për rezervat e vogla pelagjike në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18); dhe
- Rekomandimi GFCM/42/2018/8 për masat e mëtejshme emergjente në vitet 2019-2021 për rezervat e vogla pelagjike në Detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18).

